



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

## **UNESCO- Shqipëria, model i zhvillimit të trashëgimisë. Kumbaro pritet nga drejtoresha e UNESCO-s Audrey Azoulay. Azoulay: “Vlerësojmë modelin shqiptar të zhvillimit”**

2018-06-11 11:52:00



“Vlerësojmë shkëlqyeshëm punën dhe rezultatet e Shqipërisë në mbrojtjen, konservimin, restaurimin dhe sensibilizimin e trashëgimisë, me synimin e qartë për t’i dhënë zhvillim turizmit kulturor, përmes politikave të qarta në trashëgiminë kulturore. UNESCO vlerëson modelin shqiptar të zhvillimit duke theksuar se ai duhet treguar për të gjithë rajonin”- u shpreh Drejtoresha e Përgjithshme e UNESCO-s, Audrey Azoulay në takim

me Ministren e Kulturës, Mirela Kumbaro. Gjatë qëndrimit në Paris, Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro zhvilloi një vizitë në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencë dhe Kulturën, UNESCO dhe u prit në takim nga Drejtoresha e Përgjithshme e UNESCO-s, Audrey Azoulay.

“Vlerësojmë shkëlqyeshëm punën dhe rezultatet e Shqipërisë në mbrojtjen, konservimin, restaurimin dhe sensibilizimin e trashëgimisë, me synimin e qartë për t’i dhënë zhvillim turizmit kulturor, përmes politikave të qarta në trashëgiminë kulturore. UNESCO vlerëson modelin shqiptar të zhvillimit duke theksuar se ai duhet treguar për të gjithë rajonin”- u shpreh Drejtoresha e Përgjithshme e UNESCO-s, Audrey Azoulay në takim e zhvilluar me Ministren e Kulturës, Mirela Kumbaro.

Gjatë qëndrimit në Paris, Ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro zhvilloi një vizitë në Selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencë dhe Kulturën, UNESCO dhe u prit në takim nga Drejtoresha e Përgjithshme e UNESCO-s, Audrey Azoulay.

Kumbaro shprehu mbështetjen e Qeverisë për vizionin e ri për Transformimin Strategjik të UNESCO-s, dhe falenderoi organizatën për bashkëpunimin e deritanishëm. Ajo diskutoi me znj. Azoulay për rrugët dhe mjetet për ta shtrirë më tej këtë bashkëpunim. Azoulay shprehu mbështetjen e organizatës për programet e edukimit në art dhe trashëgimi, që po zbaton Shqipëria, duke vënë theksin se “Rinia dhe Kultura janë shtyllat e rëndësishme të organizatës së UNESCO-s”.

Për këtë shtoi ajo “UNESCO është e angazhuar për “Transformimin Strategjik”, i cili synon ta bëjë veprimtarinë e UNESCO-s më efektive, ta sjellë më afër nevojave dhe përparësive të vendeve anëtare. Rallë herë më parë ka qenë kaq e rëndësishme për t’u përqendruar në nxitjen dhe mbrojtjen e kulturës, në vendosjen e saj në qendër të komunikimit mes kombeve dhe popujve dhe në promovimin e zhvillimit të arsimit cilësor për të gjithë.

Kumbaro prezantoi punën e trashëgimisë në sitet botërore të mbrojtura nga UNESCO në Shqipëri, Butrint, Berat dhe Gjirokastrë, duke vënë theksin në angazhimin e qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Kulturës për të bërë bashkë ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin ekonomik. “Hapat e Shqipërisë në këtë drejtim janë të dukshme, mjaft të shohim suksesin e Rilindjes Urbane, shifrat e vizitorëve, vendas dhe të huaj, shtimin e strukturave akomoduese në qendrat e trashëgimisë kulturore, për të kuptuar se synimi i kësaj qeverie është politika e bashkëpunimit mes shtetit, privatit

dhe partnerëve tanë të rëndësishëm si Banka Botërore, Bashkimi Europian, apo Fondi Shqiptaro- Amerikan i Zhvillimit”.

Në takim me Azoulay, Ministria Kumbaro preku edhe çështjen e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO, duke vënë theksin se ajo duhet parë si një temë e kulturës universale, e ndarë nga politika dhe garantoi përpjekjet e qeverisë shqiptare për të forcuar dhe zgjeruar bashkëpunimin rajonal dhe rolin emancipues të kulturës në këtë drejtim. “Ne mbështesim kontributin kulturor të Kosovës, krahas të gjitha vendeve të tjera, në UNESCO, si në një familje të madhe kulturore ku secili është pjesë e mozaikut të kësaj hapësire pa kufi, ku sidomos të rinjtë duhet të jenë prioritet», theksoi Kumbaro- kjo nuk duhet parë si akt politik për të sfiduar ndokënd, por vetëm si nevojë e natyrshme për t’i dhënë kulturës, arsimit, shkencës dhe rinisë në Kosovë të njëjtat mundësi për bashkëpunim dhe ndërveprim si në vendet e tjera të rajonit dhe botës”.

Kumbaro ftoi drejtoreshën e UNESCO-s Azoulay për vizitë në Shqipëri me rastin e një konference të nivelit të lartë në festimet e 60 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në organizatë.

Në ditët e qëndrimit në Paris, Kumbaro zhvilloi një takim pune me Metchtild Rossler, Drejtoreshë e Qendrës së Trashëgimisë Botërore në UNESCO, ku u diskutua për zhvillimet pozitive në fushën e trashëgimisë në dy qytetet Gjirokastrë dhe Berat dhe në Parkun e Butrintit. “Jo vetëm keni plotësuar kërkesat e UNESCO-s, por njëkohësisht jeni një nga shembujt pozitivë të modelit të zhvillimit, që përkon me synimet e kësaj organizate, që synon ruajtje, mbrojtje, sensibilizim dhe zhvillim të trashëgimisë botërore” u shpreh ajo. Rossler vlerësoi hapat në zhvillim të Shqipërisë, që shënuan suksesshëm me miratimin e ligjit për trashëgiminë dhe muzetë, hapat pozitive në ndërtimin e katër muzeve të rinj bashkëkohorë, si dhe strategjinë për të sensibilizuar të gjithë aktorët shoqërorë për rëndësinë e trashëgimisë përmes programeve të edukimit dhe partneriteteve me pushtetin vendor dhe sektorin privat. Divizioni i Trashëgimisë Botërore në UNESCO shprehu vlerësime pozitive për Gjirokastrën, Butrintin, dosjen e Liqenit të Ohrit dhe kërkoi nga pala shqiptare të punojnë së bashku për të shtuar të tjera site në trashëgiminë botërore, ku u diskutua ndër të tjera për Apolloninë por edhe për element të trashëgimisë kulturore jomateriale.